

VENDIM
Nr.49, datë 21.10.2004

**PËR MIRATIMIN E MËNYRËS SË FATURIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR
ABONENTËT FAMILJARE DHE JOFAMILJARE ME MATËSA JASHTË KUSHTIT
TEKNIK**

Bordi Komisionerëve të ERE– s, në mbledhjen e tij të datës 21.10.2004, gjatë shqyrtimit të relacionit të paraqitur nga Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve në lidhje me sasinë e energjisë elektrike të përlogaritur për t'u faturuar aforfe për abonentët familjarë dhe jofamiljarë me matësa jashtë kushtit teknik

KONSTATON:

KESH sh.a. gjatë vitit kryen faturim aforfe edhe për abonentët familjarë që janë të pajisur me matje, por edhe për abonentët jofamiljarë. Për të pasur një rregull në lidhje me faturimin aforfe në të ardhmen, në rastet kur matësat janë të dëmtuar apo jashtë kushteve teknike, në zbatim të ligjit nr.9072 datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” neni 8 pika 2 germa “b” dhe neni 26 pika 1 Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

Në rastet kur KESH sh.a. konstaton se matësi i abonentit familjarë është i dëmtuar apo jashtë kushtit teknik për të realizuar një matje të saktë, e bën faturimin duke u bazuar në mesataren mujore të faturimit me matje të 3 muajve respektiv të vitit të mëparshëm.

Në rastet kur KESH sh.a. konstaton se matësi i abonentit jofamiljarë është jashtë kushtit teknik për të realizuar një matje të saktë, e bën faturimin duke u bazuar në konsumin mesatar mujor të faturuar me matje të 3 muajve të fundit.

Në rastet kur KESH sh.a. konstaton se matësi i abonentit jofamiljarë është i dëmtuar, e bën faturimin duke u bazuar në fuqinë e instaluar dhe koeficientin të shfrytëzimit ditor të kësaj fuqie.

Periodha e faturimit aforfe në këto raste të jetë jo më shumë se një muaj.

Ngarkohet KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema